



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 504/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.504/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin nr.2112B/01R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.504/2019 nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 21.11.2019, gjatë ndërrimit të dytë të punës (nga ora 16:00-24:00), në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit të votave në kutinë e votimit nr.2112B/01R, është shpallur i pavlefshëm 1 fletëvotim, i cili i takon subjektit politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilin fletëvotim, votuesi me rastin e votimit ka vendosur tikun në rubrikën e koalicionit NISMA-AKR-PD, mirëpo në sipërfaqen e fletëvotimit në fjalë poashtu vërehet edhe një shkrim në formë të shkronjës “X”, shkrim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës është vendosur qëllimisht nga persona të tretë dhe me laps kimik të ndryshëm nga ai i votuesit. Në fund paraqitësi i ankesës ka shtuar se konsideron se në fletëvotimin në fjalë qëllimi i votuesit është i qartë andaj ka propozuar që PZAP-i ta aprovojë ankesën, që fletëvotimin në vendvotimin nr.2112B/01R, ta shpallë të vlefshëm dhe ta obligojë KQZ-QNR, që këtë ta përfshijë në rezultatin përfundimtar të koalicionit NISMA-AKR-PD.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për të argumentuar pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një mostër të fletëvotimit të vlefshëm sipas Doracakut të KQZ-së, shtojca 7 dhe një kopje të fletëvotimit nr.2112B/01R, në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 23.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se lidhur me shpalljen e fletëvotimit të pavlefshëm, QNR-ja, në bazë të procedurës ka vlerësuar se fletëvotimi në fjalë është i pavlefshëm për arsye se nuk dihet qëllimi i qartë i votuesit dhe shkronja X është shenjë identifikuese e pavlefshmërisë, që d.m.th fletëvotimi është dëmtuar qëllimshëm.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: nr.2112B/01R, gjatë procesit të rinumërimit, është shpallur i pavlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së, në të cilin votuesi me rastin e votimit ka vendosur tikun në rubrikën e koalicionit NISMA-AKR-PD, mirëpo pothuajse e gjithë sipërfaqja e këtij fletëvotimi përshkohet nga një "X", që prek shkrimin e shumicës së subjekteve politike të evidentuara në fletëvotim.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 4 lidhur me ndryshimin e nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i vlefshëm sepse bie në kundërshtim me Doracakun e KQZ-së.

Paneli, me rastin e vendosjes sipas ankesës, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës dhe provat e bashkangjitura, përgjigjen në ankesë të KQZ-së dhe konstatoi se pretendimet e paraqitësit të ankesës me të cilat ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në kutinë e votimit nr.2112B/01R, nuk qëndrojnë për shkak se fletëvotimi në fjalë nuk i përmbushë kriteret e vlefshmërisë, fakt ky i vërtetuar nga kopja e fletëvotimit nr.2112B/01R, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nga e cila konstatohet se megjithëse votuesi ka vendosur tikun në rubrikën e koalicionit NISMA-AKR-PD, pothuajse e gjithë sipërfaqja e këtij fletëvotimi përshkohet nga një "X", që prek shkrimin e shumicës së subjekteve politike të evidentuara në fletëvotim, nga çka rezulton se ky fletëvotim është dëmtuar qëllimshëm andaj nuk i përmbushë kriteret e vlefshmërisë, ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore dhe me doracakun e KQZ-së, andaj Paneli vendosi që ta refuzojë ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, si të pabazuar, sepse nuk ka qenë e mundur te vërtetohet qëllimi i votuesit në rastin konkret.

Nga sa u tha më lart e në kuptim të nenit 117 dhe 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 504/2019 më datë 24.11.2019**

**Kryesues i Panelit**  
**Adnan Konushevcij**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***